



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 2-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 24.02.2022, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 13⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Arsim Jashari, anëtar
5. Egzona Bytyqi, anëtare
6. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Latif Ramadani, DBF
2. Shkelzen Hajdini, DSH
3. Kimete Jashanica, OSBE
4. Merita Bytyqi, Sektori i Kuvendit

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti *Behar Aliu*.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 1-të e KPF-së.
2. Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2021.
3. Propozim Vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit për vitet 2020 dhe 2021 në vitin 2022.
4. Propozim Vendim për aprovimin e rezervës komunale 2022.

5. Propozim Vendim për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të
6. Propozim Vendim për fillimin e procedurës për përmirësimin dhe harmonizimin e mospërputhjeve të vlerave të veçanta teknike të caktuara me Hartën Zonale të Komunës.
7. Propozim Vendim për formimin e komisionit të ankesave

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreh rendit të ditës?

Pasi që nuk pati plotësime as vërejtje kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat, 6 për, aprovoi:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 1-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 6 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 1-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

II

Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2021.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi,i dha fjalën Latif Ramadanit DBF-s, i cili i njoftoi në pika të shkurta me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, tha qe e përkrahi këtë propozim,po ashtu i falënderoj qytetarët për kontributin e dhënë. Por kam edhe një rekomandim qe te ndërtohet një shtëpi e re e shëndetit në Lipjan pasi qe është shumë e nevojshme. Investimet te cilat po bëhen qe disa vite nuk është qe po kanë edhe aq efekt.

Egzona Bytyqi,tha se ju përgëzoj për të hyrat po ashtu edhe qytetarët i falënderojë, kam një propozim qe të renovimi i tualeteve në QKMF të vazhdoj edhe në QMF dhe AMF pasi qe është shumë e nevojshme. dhe kërkoj qe puna të bëhet sa më mirë qe është e mundëshme.

Alban Salihu tha se edhe unë e përkrahu këtë rritje po ashtu i falënderoj qytetarët për vedijësimin dhe kontributin e tyre. Kam një pyetje me krahasuar me vitin e kaluar a kemi rritje te te hyrave.

Latif Ramadani, ne e kemi kaluar tavanin e te hyrave te cilin tavan e cakton ministria e financave.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, , vendosi që propozim vendimi t`i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

III

Propozim Vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit për vitet 2020 dhe 2021 në vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit drejtor i DBF, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha sa i përket këtij propozimi përkrahim dhe çdo propozim i cili do të jetë në të mirën e qytetarëve na do ta përkrahim.

Egzona Bytyti tha se e përkrahim këtë propozim vendim, vetëm do të ishte mirë të specifikohet se cilat aparate do të blihen për QKMF.

Daut Azemi, kryesues i Kuvendit tha se drejtori i shëndetësisë ka bërë kërkesë për disa aparate dhe disa prej tyre janë përfshi këtu..

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

4. Propozim Vendim për aprovimin e rezervës komunale 2022.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i a dha fjalën, Latif Ramadanit drejtor i DBF, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim Vendim për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Semetishtit drejt i DPU, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari tha se kjo është një çështje e ndjeshme dhe duhet me pas kujdes se ka po bazohet zhvillimi ekonomik pasi mund te dëmtohet qytetarët.

Alban Salihu, a dihet kur do të përfundoj ky projekt dhe a do të jenë anëtarët e kuvendit pjesë e ekipës.

Imri Semetishti, nuk e di që se sa do të zgjas ky projekt, komisionet do te caktohen nga kryetari i komunës por edhe kuvendi do te jetë aktiv ne këtë proces. Ne do te mundohemi te kemi nje plan sa ma real dhe sa me te zbatueshëm.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim Vendim për fillimin e procedurës për përmirësimin dhe harmonizimin e mospërputhjeve të vlerave të veçanta teknike të caktuara me Hartën Zonale të Komunës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Semetishtit drejtor i DUPH, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, çështje shumë e ndjeshme, të cilën grupi i PDK-së e ka kundërshtuar edhe me herët. Po ashtu PDK-ja i ka pas dhënë propozimet e tyre por nuk janë marr parasysh. Dhe kjo tani na ka kthyer në piken zero dhe është mirë që te gjithë me u bo bashkë që te bëjmë më të mirën për qytetarët e Lipjanit dhe mos te

dëmtohet askush. Po ashtu hartat zonale nuk janë publikuar për 6 muaj dhe për këtë dikush duhet me dhen përgjegjësi

Alban Salihu, tha se komunën tonë po mungojnë njohësit e kësaj fushe. Kam një pyetje çka po ndodhë me disa qytetarë të cilët po i marrin lejet ndërtimore pastaj po protestohet nga qytetarët dhe po ju ndërprehet puna pse po ndodhë kjo.

Imri Semetishti, tha se ne do të mundohemi të bëjmë ma të mirën sa i përket hartave zonale duke u bazuar në gjendje faktike. Harta zonale nuk do të kthehet në zero por vetëm do të ndryshohen ato ku drejtorati jonë i ka pa si pengesa. Pasi që gjendja në teren është ndryshe.

Arsim Jashari, tha se PDK-ja i ka ngritë disa shqetësime dhe ato nuk janë marr parasysh pasi që gjendja faktike ka qenë ndryshe me atë të cilën është në harta zonale.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se hartat zonale janë bërë për herë të parë në nivel vendi dhe Ministria pat thënë në fillim që do të bëjnë hartat zonale qendrore pastaj komunat të bazohen në to, pastaj skan mjete të bëjnë asgjë dhe ju kanë thënë komunave merrni ju njëherë me to e ,me i marr te gatshme prej komunave. Ne do të mundohemi ta bëjmë më të mirën e mundshme për qytetarët e komunës tonë. Edhe drejtori e dha një sqarim shumë të mirë për neve.

Arsim Jashari, tha është mirë që idetë e mira me i marr parasysh pavarësisht se kush i jep ato ideja pozita apo opozita

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat për 7, vendosi që propozim vendimi të i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

7. Propozim Vendim për formimin e komisionit të ankesave

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Valon Pacollit drejtor i DEZH, i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, do të ishte mirë që këta anëtarë me i taku opozitës?

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se kështu është sipas udhëzimit administrativ.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat për 7, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14,²⁰

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi